



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri: KSC-BC-2020-05

Vendos: Gjykatësi i procedurës paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi parashtrues: Prokurori i Specializuar

Data: 24 shtator 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*

Kërkesë për riklasifikim

Zyra e Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

1. Më 12 qershor 2020, gjykatësi i procedurës paraprake konfirmoi¹ një aktakuzë kundër Salih MUSTAFËS.²
2. Në atë kohë, gjykatësi i procedurës paraprake miratoi gjithashtu një kërkesë për mosnxjerrjen e aktakuzës së konfirmuar për publikun deri në një urdhër të mëtejshëm.³ Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS') kërkon që Aktakuza e Konfirmuar e Redaktuar të riklasifikohet si publike menjëherë pas transferimit nga Administratorja të z. MUSTAFA në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë.
3. ZPS-ja më tej konfirmon se nuk kundërshton që Fletarrestimi⁴ dhe Urdhri i Transferimit të riklasifikohen si publikë.⁵ Gjithsesi do të ishte e përshtatshme që në versionet publike të mundshme të këtyre dy dokumenteve të redaktohen disa të dhëna personale.⁶
4. Ky parashtrim është rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* në përputhje me rregullën 82(4).

Numri i fjalëve në origjinal: 252

/nënshkrimi/

Xhek Smith
Prokurori i Specializuar

E enjte, 24 shtator 2020

Në Hagë, Holandë

¹ Vendim për konfirmimin e Aktakuzës kundër Salih Mustafës, KSC-BC-2020-05/F00008, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* ('Vendimi i konfirmimit').

² Parashtrimi i aktakuzës së konfirmuar, KSC-BC-2020-05/F00011, 19 qershor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcat rreptësisht konfidenciale KSC-BC-2020-05/F00011/A01 ('Aktakuza e Konfirmuar') dhe KSC-BC-2020-05/F00011/A02 ('Aktakuza e Konfirmuar e Redaktuar').

³ Vendimi i konfirmimit, KSC-BC-2020-05/F00008, para.163(f).

⁴ Fletarrestim për z. Salih MUSTAFA, KSC-BC-2020-05/F00009/A01, 12 qershor 2020 ('Fletarrestimi').

⁵ Urdhër për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, KSC-BC-2020-05/F00009/A01, 12 qershor 2020 ('Urdhri i Transferimit').

⁶ Shih Fletarrestimin, KSC-BC-2020-05/F00009/A01, f.1 (ku jepet numri personal i identifikimit dhe adresa e fundit e ditur); Urdhri i Transferimit, KSC-BC-2020-05/F00009/A02, f.1 (ku gjithashtu jepet numri personal i identifikimit dhe adresa e fundit e ditur). Në qoftë se gjykatësi i procedurës paraprake dëshiron të bëjë riklasifikimin e vetë Vendimit të konfirmimit, ZPS-ja kërkon që t'i jepet mundësi të propozojë disa redaktime të mëtejshme.